

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.



Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësive të institucioneve, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Maj 2024

Komiteti Koordinativ Antikorrupsion miraton raportin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2023 dhe i hap udhë diskutimit të strategjisë së re

23.05.2024: Komiteti Koordinativ për zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit miratoi raportin e monitorimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, për vitin 2023. Ministri për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin njëherazi Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit, znj. Adea Pirdeni mbledhi takimin e parë për vitin 2024, ku u diskutua dhe miratua (I) raporti i monitorimit për vitin 2023, u prezantua (II) dokumenti i ri strategjisë së re kundër korrupsionit për vitet 2024-2030 dhe (III) përgatitja e raportit të Shqipërisë për GRECO. Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion 2023 përmban të dhëna për zbatimin e masave dhe aktiviteteve dhe nivelin e zbatimit të objektivëve të strategjisë antikorrupsionin për vitin 2023, i cili është viti i 9-të i zbatimit të strategjisë. Strategjia Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit për vitin 2023 ka shënuar një nivel zbatimi në masën 71%. Gjithashtu, në këtë takim u vijua me prezantimin e dokumentit të ri strategjik antikorrupsion, mekanizmave të politikave primare që ajo do të rregullojë, përmbajtjen e planit të veprimit 2024-2026 si dhe treguesit kryesorë të matjes së rezultateve të pritshme përgjatë viteve të zbatimit në 7 vitet e ardhshme. Komiteti Koordinativ u njoh gjithashtu me përgatitjet dhe analizën e informacionit që do të jetë pjesë e raportit të Shqipërisë për tu paraqitur në GRECO në kuadër të vlerësimit të Raundit V. Takimi i Komitetit Koordinativ ishte i hapur për përfaqësues të shoqërisë civile, sektorit të biznesit privat dhe partnerë të organizatave të huaja në vend.



Raportin final të monitorimit 2023 të miratuar, mund ta gjeni në link: <https://www.drejtesia.gov.al/raporte-monitorimi-2023/>.



35 këshilltarë politikë të ministrave certifikohen për njohuritë e marra në fushën e integritetit dhe luftës kundër korrupsionit

02.05.2024: 35 këshilltarë të ministrave të kabinetit qeveritar përfunduan me sukses kurrikulën e trajnimit online (self-learning) "Hyrie në parandalimin e korrupsionit". Kursi është një kurrikul e posaçme në kuadër të Programit Edukimi për të Drejtat e Njeriut për Profesionistët Ligjorë (HELP) të Këshillit të Evropës, i cili iu ofrua në gjuhën shqipe funksionarëve politikë publikë për të rritur informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për integritetin dhe luftën kundër korrupsionit. Këshilltarët politikë ndoqën 13 module thelbësore në përmbajtje të programit, si përkatësisht: (1) Kuptimi i korrupsionit; (2) Instrumentet për parandalimin e korrupsionit; (3) Parimet etike dhe kodet e sjelljes; (4) Konflikti i interesit dhe papajtueshmëritë; (5) Kufizimet pas largimit nga detyra; (6) Dhuratat dhe përfitimet e tjera; (7) Deklarimi i pasurisë; (8) Qasja e lirë në informacion; (9) Lobimi; (10) Financimi i partive politike; (11) Sinjalizimi; (12) Prokurimi publik dhe (13) Auditimi i veprimtarisë publike. Në përfundim të kursit u zhvillua edhe një test final dhe këshilltarët politikë u pajisën me certifikatë pjesëmarrjeje. 35 pjesëmarrësit teknike nga dy tutorë që ishin suportues në platformë, të cilët nxisnin diskutimet, referonin çështje në lidhje me trajnimin dhe mbështesnin pjesëmarrësit nga ana teknike. Kurrikula është bërë pjesë e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nisma do të shërbejë gjithashtu raportimit të Shqipërisë në GRECO.

"Edukimi kundër korrupsionit" takime në dy gjimnazet e Gjirokastrës dhe të Durrësit

02-03.05.2024: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit përfundoi ciklin e takimeve për vitin e parë akademik në zbatim të projektit "Edukimi kundër korrupsionit" në 2 shkollat e mesme të arsimit të lartë, në Gjirokastrë dhe në Durrës.

Në 02.05.2024, u zhvillua takimi në shkollën e mesme të arsimit të lartë, në Gjirokastrë, një takim që u mundësua në formë hibride. Në shkollën "Asim Zeneli", mësuesit dhe nxënësit pritën specialistët e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe oficerët e agjencisë ligjzbatuese italiane në Shqipëri "Guardia di Finanza". Video nga veprimtaria antikorrupsion dhe veprimtari të tjera kundër aktiviteteve të paligjshme u ndanë për nxënësit, informacione publike për luftën kundër korrupsionit u ofruan për auditorin. Pas përfundimit të prezantimeve u zhvillua një bisedë interaktive me nxënësit të cilët sollën shembuj nga eksperiencia e tyre e përditshme në shkollë në përballje me paligjshmëri dhe raste të dyshuara për korrupsion.



Në datë 03.05.2024, u zhvillua takimi mbyllës i këtij cikli takimesh për vitin e parë akademik, në zbatim të projektit, në shkollën "Naim Frashëri" në qytetin e Durrësit. Stafi i politikave kundër korrupsionit dhe kolegët italianë, ekspertë profesionistë në fushën e ligjshmërisë, së bashku me nxënësit e klasave të 10-ta bashkëpunuan dhe shkëmbyen idetë për të gjetur mënyra të vendosjes së standarteve të mira në shoqëri. Stafi antikorrupsion risolli kërkesën për të marrë indicie për të përcjellë mesazhet kundër korrupsionit, video ndërgjegjësuese e informative për njësitë e specializuara kundër korrupsionit. Ekspertët italianë diskutuan për luftën kundër korrupsionit, integritetin dhe kulturën e zbatimit të ligjit.

Nisma e perbashkët e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit si dhe Ambasadën Italiane në Tiranë pritet të vijojë me fillimin e vitit të ri akademik, 2024-2025.

"Besimi në qeverisje 2023" si urë bashkëpunimi qeveri-shoqëri civile

21.05.2024: Ministri i Shtetit Për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin znj. Adea Pirdeni, rrit kuadrin e bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile në vend në aktivitetin e tyre të hulumtimit në kuadër të qeverisjes së mirë dhe luftës kundër korrupsionit. Organizata IDM Albania publikoi për vitin e 11-të sondazhin "Besimi në qeverisje 2023". Ministri Pirdeni morri pjesë në aktivitetin promovues të këtij indeksi perceptimi duke inkurajuar zërin dhe rolin e organizatave civile për më shumë gjithëpërfshirje dhe aktivitet. Pirdeni pranoi rezultatet e indeksit si formë e transparencës dhe llogaridhënies së administratës publike për të ofruar qeverisje më të mirë dhe të hapur. Sondazhi i vitit 2023 përfshiu vlerësimin e perceptimit publik se sa efektive janë institucionet dhe strukturat publike në luftën kundër korrupsionit në vend. Të dhënat tregojnë se SPAK është institucioni që qytetarët e perceptojnë si më efektiv në trajtimin e korrupsionit, me 60.9% që shprehin besim të madh ose nivel bazë besimi. Sondazhi i vitit 2023 tregoi gjithashtu një nivel të lartë ndërgjegjësimi për shërbimet elektronike të ofruara nga e-Albania, me 92% të të anketuarve të vetëdijshëm për platformën. Ndër ta, 75.6% i kanë përdorur shërbimet në vitin 2023. Pjesa më e madhe e përdoruesve e konsideron e-Albanian si funksional (84.7%) dhe që i ofron qytetarëve ndihmën e nevojshme (59.7%).

